

"Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Barazia Gjinore" - Program i ri i FSHDPAK

Faqe 2



Hapa të mëtejshëm për një zhvillim gjithpërfshirës

Faqe 2



Studimi i kuadrit ligjor mbi vlerësimin e aftësisë të kufizuar në Shqipëri

Faqe 7

Zyra ligjore Vlorë në ndihmë të "Shoqatës të invalidëve para dhe tetraplegjik"

Faqe 6



Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara, përdorues të karrigeve me rrota në Shqipëri

Faqe 4



Hapa të mëtejshëm për një zhvillim gjithpërfshirës

Përmes një projekti të mbështetur nga World Learning Forecast / USAID, po vazhdon aktivitetin e tij "Koalicioni Shqiptar-Aftësia e Kufizuar dhe Zhvillimi". Në këtë kuadër u zhvillua një takim i Koalicionit, ku

anëtarët u njohën ndër të tjera me eksperiencat pozitive të disa organizatave të personave me aftësi të kufizuar që bashkëpunuan me programe të USAID për zhvillimin e një komuniteti gjithpërfshirës.

Në takim ishte i ftuar edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Shëndetësisë që njohu pjesëmarrësit me vizionin e kësaj ministrie në lidhje me problematikat e aftësisë së kufizuar. Në kuadrin e projektit të World Learning po punohet gjithashtu për ngritjen e faqes së internetit dhe përgatitjes së dy numrave për revistën e Koalicionit.

"Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Barazia Gjinore" - Program i ri i FSHDPAK

Në nëntor 2008, me mbështetjen e "Agjencisë së Ndihmës për Zhvillim Nërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës-USAID", FSHDPAK filloi një program të ri me fokus "Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Barazia Gjinore".

Përmes këtij projekti, FSHDPAK do të përqipet të adresojë mungesën e politikave, legjisllacionit apo praktikave që promovojnë pjesëmarrjen mbi bazat e barazisë të vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara në shoqërinë Shqiptare. Kjo do të realizohet përmes

ndërhyrjeve në të gjitha nivelet: një nga drejtimet bazë do të jetë fuqizimi dhe krijimi i një rrjeti të grave me aftësi të kufizuara, që do të përbëjë një mjet të fuqishëm avokacie që do të nxisë dhe promovojë gjithpërfshirjen e problemtikës së tyre në politikat e kuadrin ligjor relevant, njëkohësisht edhe në programet për zhvillim në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar.

Projekti do të zbatohet për një periudhë 10 mujore, në dy qytete, Tiranë dhe Shkodër.



Tregtise dhe Industrisë, Zyrave Rajonale të Tatimeve, Zyrave Rajonale të Punës, përfaqësues të OJF, ofrues të shërbimeve për grupet vulnerabël, përfaqësues të bizneseve.

Materializimi i vlerësimit të bashkëpunimit dhe nxjerrja e rekomandimeve për të ardhmen u bë përmes botimit të raportit "Përgjegjësia sociale e komunitetit të biznesit dhe grupet në nevojë", i pari në vend që merr në konsideratë kontributin e biznesit në ndihmë të grupeve vulnerabël. Për t'u njohur me raportin www.adrf.org.al.

Projekti gjithashtu përmes trainimeve dhe seminareve të zhvilluara në rajonet përkatëse dhe me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të përfshirë, krijoi mundësitë për të debatuar, shkëmbyer eksperiencën dhe diskutuar në rrjet specialistësh konkluzionet dhe rekomandimet e studimit.

Për të bërë publike këtë iniciativë por edhe për të zgjeruar rrjetin e përfutësve u përgatitën dhe realizuan: 2 debate të hapura televizive, 1 spot publicitar si dhe një paketë informative.

Nxitja e përgjegjësisë sociale të komunitetit të biznesit në Shqipëri ndaj problematikës së grupeve të marginalizuara

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar me mbështetjen e fondacionit SOROS mori iniciativën përmes projektit "Nxitja e përgjegjësisë sociale të komunitetit të biznesit në Shqipëri ndaj problematikës së grupeve të marginalizuara", të bëjë një vlerësim të klimës së komunikimit dhe bashkëpunimit mes

komunitetit të biznesit dhe organizatave jofitimprurëse me fokus grupet në nevojë dhe rekomandime të mundshme për ndryshim në tre rajone të vendit: Elbasan, Korçë dhe Shkodër. Në funksion të këtij vlerësimi projekti bëri aktiv një rrjet të zgjeruar me aktorë të mundshëm për të dhënë kontributin e tyre; Drejtues dhe përfaqësues të Dhomave të

Promovim i ndryshimit në platformat politike të partive përmes dialogut të personave me aftësi të kufizuar dhe politikanëve

Kjo iniciativë e re e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar mbështetur nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, synon të nxisë.

Pjesëmarrjen e qytetarëve me aftësi të kufizuar në vendimmarrjet për çështje të rëndësishme, duke ndërgjyegjësuar drejtues dhe anëtarë të partive politike për atë se si përgjegjësitë e tyre si të zgjedhur lidhen me adresimin e problematikave të personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri.

Ky objektivi themelor do të arrihet përmes aktiviteteve ndërgjyegjësuuese si dhe një vlerësimi të hollësishëm të asaj se Sa dhe Si partitë kryesore politike në Shqipëri reflektojnë në programet e tyre politike dhe elektorale nevojat e personave me aftësi të kufizuar dhe problematikave të fushës së aftësisë së kufizuar. Konkluzionet dhe rekomandimet e këtij vlerësimi do të bëhen të njohura në vijim për partitë politike, komunitetin e personave me aftësi të kufizuar dhe publikun më gjërë.

Shërbime mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara, përdorues të karrigeve me rrota në Shqipëri

Me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), është bërë e mundur vazhdimi i procesit të prodhimit të karrigeve me rrota në punishten "Mirësia" për persona me aftësi të kufizuara në nevojë. Falë këtij projekti që nga viti 2004 e deri në përfundim të tij në Nëntor 2008 janë prodhuar 840 karrige me rrota për persona me aftësi të kufizuara, të cilat janë shpërndarë në të gjitha rajonet e vendit, në zonat rurale dhe ato urbane. Përfituesit kanë marrë informacion për çështje të aftësisë së kufizuar si dhe për përdorimin e karriges me rrota. Ky projekt ka mundur punësimin në punishten "Mirësia" të 5 personave me aftësi të kufizuara, 2 prej të cilëve përdorues të karriges me rrota.

Me mbështetjen e USAID është mundur organizimi i Kampit të 10 të Rehabilitimit Aktiv "Aftësim për jetesë të pavarur" (17 - 22 Shtator 2008, Mali i Robit, Resort, Durrës) i cili ka për qëllim të trajnojë përdoruesit e rinj të karrigeve me rrota dhe familjarët e tyre për të fituar aftësi praktike për përdorimin e karrigeve me rrota duke kontribuar për pavarësinë e tyre në jetë.

Gjithashtu në kuadër të këtij projekti dhe si një nga synimet e tij themelore ishte dhe lobimi për zbatimin e "Startegjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara" (SKPAK) në nivel lokal. Në vijim të këtyre përpjekjeve të FSHDPAK, në Prefekturën e Shkodrës më 23 Dhjetor 2008 nënshkruhet për herë të parë një marrëveshje bashkëpunimi nga Prefekti i Shkodrës dhe Ministri i Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të



Barabarta me prezencën edhe të përfaqësuesve të USAID, FSHDPAK, Kryetarë të bashkive të qarkut Shkodër si dhe përfaqësues të OJF të fushës.

Projekti influencoi gjithashtu përmes lobimit të programit të avokatisë në propozime konkrete për përmirësime të politikave dhe kuadrit ligjor ekzistues në fushën e përshtatshmërisë.

Falë këtij projekti që nga viti 2004 e deri në përfundim të tij në Nëntor 2008 janë prodhuar 840 karrige me rrota për persona me aftësi të kufizuara, të cilat janë shpërndarë në të gjitha rajonet e vendit, në zonat rurale dhe ato urbane.

Për të parë nga afër ecurinë e aktivitetit të punishtes "Mirësia" si dhe për të vlerësuar mundësitë e vazhdimësisë së mbështetjes së USAID për projektin e prodhimit të karrigeve me rrota më 21 tetor 2008, Znj. Roberta Mahoney, Drejtore e Misionit të USAID në Shqipëri, zhvilloi një vizitë në punishten "Mirësia".

Në kuadër të këtij projekti, FSHDPAK ka lobuar fuqishëm për të siguruar mbështetjen e shtetit në subvencionimin e shërbimit të prodhimit të karrigeve me rrota në punishten "Mirësia".

Në vizitën e bërë në punishten "Mirësia" më 2 Dhjetor 2008, Ministri i Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta u shpreh se do të jetë në prioritetet e MPÇSSH mbështetja e një shërbimi kaq të domosdoshëm e të kërkuar për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Vodafone Albania, tashmë nëpërmjet Fondacionit Vodafone Albania ka mbështetur vazhdimisht gjatë 5 viteve të fundit (2003 - 2008) realizimin e prodhimit të 200 karrigeve me rrota në punishten "Miresia", kampingun e trajnimit të tyre, si dhe aktivitete të tjera rehabilituese për personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri, duke u bërë një shembull i biznesit të përgjegjshëm në kontributin ndaj njerëzve në nevojë.

Projekti i mbështetur së fundmi nga Fondacioni Vodafone - Albania, bëri të mundur prodhimin dhe shpërndarjen e 50 karrigeve me rrota për persona me aftësi të kufizuar nga rajonet Durrës, Tiranë dhe Elbasan si dhe mbështetjen e Kampit të 11 të Rehabilitimit Aktiv "Aftësim për jetesë të pavarur" (10 -13 Tetor, 2008, Mali i Robit, Resort, Durrës) për persona me aftësi me aftësi të kufizuar dhe familjarë të tyre nga të gjitha rajonet e vendit. Për të bërë publike këtë ekperiencë 5 vjeçare bashkëpunimi, si dhe për njoftuar vazhdimësinë e mbështetjes, më 3 Dhjetor 2008,



Ditën Ndërkombëtare të Aftësisë së Kufizuar u organizua një takim më pjesëmarrjen e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Drejtues të Vodafone-Albania, përfaqësues të Fondacionit Vodafone-Albania, përfaqësues të FSHDPAK, përfaqësues të OJF, përfitues, persona me aftësi të kufizuar. ProCredit Bank përmes mbështetjes financiare dhënë FSHDPAK mundësoi prodhimin e 10 karrigeve me rrota në punishten "Mirësia" për persona me aftësi të kufizuar në nevojë. Personat me aftësi të kufizuar të cilët u pajisën me karrige

me rrota me mbështetjen e ProCredit Bank u referuan nga lista e paraqitur pranë FSHDPAK nga Shoqata Kombëtare e Para-Tetraplegjikëve me Traumë në Shtyllën Kurrizore, të gjithë i përkisnin rajonit të Tiranës.

Shpërndarja e karrigeve me rrota personave me aftësi të kufizuar u bë nga stafi i FSHDPAK në familjet e këtyre personave. Në shpërndarjen e disa prej karrigeve me rrota morën pjesë edhe përfaqësues të ProCredit Bank. Përfituesve iu shpërndanë materiale informative për aftësinë e kufizuar dhe për përdorimin e karriges me rrota.

Ndihme ligjore për E.E nga zyra ligjore Tiranë

E.E, 32 vjeçar me diagnozën paraplegji është aksidentuar në vitin 2007 në shtetin Grek. Nodhur në kushte shumë të vështira ekonomike, pa të ardhura dhe i pastrehë kërkoi ndihmë në Programin ligjor.

Fillimisht avokatët që veprojnë pranë këtij programi bënë të mundur sistemimin e të riut në qendrën rezidenciale "Marikaj", ku ai tashmë jeton prej Dhjetorit 2008.

Në plan të dytë programi ligjor asistoi E.E gjatë gjithë procesit të procedural për përfitimin e pagesës së aftësisë të kufizuar. Në kuadër të mbështetjes dhe lehtësimit të procedurave për vetë natyrën që paraqiste ky rast, Avokatja e programit ligjor realizoi takim me

Nën.Kryetarin e Njësisë Bashkiake nr. 4 dhe Drejtoreshën e Zyrës Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Ndihma e ofruar nuk ishte vetëm teknike dhe ligjore por edhe ndihmë financiare.

Plotësimi i gjithë dokumentacionit mjeksor (ekzaminimet dhe analizat mjeksore) si dhe dokumentacioni ligjor u bë i mundur edhe falë mbështetjes financiare që FSHDPAK po ofron për të riun deri në përfitimin prej tij të pagesës së aftësisë të kufizuar në Mars 2009.



Konferenca Kombëtare mbi prezantimin e Raportit të dytë të Monitorimit të SKPAK

Më 23 Tetor 2008, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) organizoi Konferencën "Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar (SKPAK)" me qëllim prezantimin e raportit të dytë të monitorimit të Planit Kombëtar të Veprimit të SKPAK, i cili përmban vlerësime mbi pesë fushat e këtij plani, në gjashtë qytete kryesore të Shqipërisë: Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Korçë e Vlorë. Në këtë konferencë, nga Znj. Blerta Çani, Drejtore Ekzekutive e FSHDPAK u bë



prezantimi i gjetjeve të raportit dhe rekomandimet për veprime në të ardhmen. Gjithashtu nga përfaqësues te Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, u prezantuan planet e këtyre institucioneve në zbatim të SKPAK për vitin në vijim. Gjithashtu në konferencë u prezantua modeli i qarkut të Shkodrës për zbatimin e SKPAK në nivel lokal.

Në konferencë morën pjesë: Zv. Kryeministri Z. Genc Pollo, Ministri i Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Z. Anastas Duro, Znj. Roberta Mahoney, Drejtore e misionit të USAID në Shqipëri, përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për problematikën e aftësisë së kufizuar, përfaqësues të OJF të aftësisë së kufizuar dhe persona me aftësi të kufizuar.



Zyra ligjore Vlorë në ndihmë të "Shoqatës të Invalidëve para dhe tetraplegjik"

Nisur nga ankesa e "Shoqatës të Invalidëve para dhe tetraplegjik" Vlorë, të cilët prej disa vjetësh vuajnë mungesën e një ambjenti pune për ushtrimin e aktivitetit tyre, Avokatja e Zyrës Ligjore në Vlorë mori iniciativën për të lobuar në favor të kësaj shoqate.

Avokatja paraprakisht bëri disa takime Nën Kryetarin e Bashkisë Vlorë dhe me anëtarë të Komsionit të Ekonomisë pranë Këshillit Bashkiak të këtij qyteti, si organi që mund ti jepte zgjidhje kësaj situatë. Avokatia i njohu përfaqësuesit e pushtetit vendor me problematikën mjaft të mprehtë që po perjeton kjo pjesë e shoqërisë në qytetin e Vlores dhe në veçanti të kësaj shoqate duke argumentuar si

zgjidhje të efektshme përfshirjen në projekt-buxhetin e 2009 burime financimi për marrjen me qera të një ambjenti të përshtatshëm për të kryer aktivitetin kjo shoqate. Në mbledhjen e radhës së komisionit për diskutimin e projekt buxhetit, u diskutua dhe u vendos dhënia e një prej ambienteve të "Pallatit të Kultures Vlore" prone e Bashkisë në favor të kësaj shoqate. Prej 2 muajsh shoqata ushtron aktivitetin pranë kësaj godine, tashmë të rikonstruktuar ndërkohë që Avokatja e zyrës Vlorë ka vazhduar takimet me kryetarin e Dhomes së Tregëtisë dhe Industrisë dhe disa biznesmene të Vlores për të ndihmuar në pajisjen e kesaj zyre me kompjuter, telefon fiks si dhe internet.

Qendra e Zhvillimit të Shanseve të Barabarta, ka zhvilluar një sërë aktivitete të cilat kanë patur si synim integrimin e personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve të tyre në jetën sociale. Shërbimet e qendrës kanë qënë të fokusuar në drejtim të arsimimit të personave me aftësi të kufizuar, ku 80 fëmijë janë integruar në shkolla publike dhe vlen për t'u përmendur që 20 prej tyre janë integruar gjatë vitit të ri shkollor 2008 - 2009. Integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuar në shkolla publike është shoqëruar edhe me informimin dhe trajnimin e mësuesve të cilët punojnë direkt me fëmijët. Gjithashtu është punuar në drejtim të integritit të personave me aftësi të kufizuar përmes punësimit dhe për këtë qendra ka bashkëpunuar me qendra të formimit profesional dhe biznese që ushtrojnë aktivitetin në rajonin e Shkodrës.

Në vazhdimësi qendra ka ofruar mbështetje ligjore për personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre. Personat që kanë kërkuar

Qendra e Zhvillimit të Shanseve të Barabarta, Shkodër

ndihmë pranë kësaj qendre kanë shfaqur nevoja të ndryshme si në planin social, ashtu dhe në aspektin juridik duke përfituar edhe asistencën e kërkuar. Përkatësisht 128 persona kanë kërkuar orientim ligjor pranë qendrës vetëm gjatë gjashtëmuorit të dytë, duke përfshirë ndihmën ekonomike, kujdestarinë, pensionin e invaliditetit, strehimin, etj. Njëkohësisht, këto persona kanë marrë këshillim, mbështetje burimore dhe sociale.

Çdo të enjte, me grupin e prindërve zhvillohen pranë qendrës takimet me grupet e prindërve të cilat karakterizohen nga një pjesëmarrje e gjërë e PAK dhe familjarë. Gjatë këtyre takimeve, diskutimet kanë qënë kryesisht të përqëndruara në planin e integritit të PAK, në jetën sociale, si dhe mbi mënyrat e zgjerimit të rrjetit dhe të bashkëpunimit në nivel lokal me institucionet përkatëse, median,

etj. Rreth 24 takime janë zhvilluar gjatë gjashtëmuorit të fundit. Aktualisht rrjeti i personave me aftësi të kufizuar dhe familjarëve përbëhet nga 90 persona.

Gjatë aktivitetit të saj Qendra e Zhvillimit të Shanseve të Barabarta Shkodër, ka qënë e përfshirë në një gamë të gjërë aktivitete të cilat kanë kontribuar në rritjen e përgjegjësisë të aktorëve lokalë, duke synuar shërbime konkrete për persona me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre. Kjo është arritur përmes trainimeve seminareve me pjesëmarrjen e drejtuesve dhe specialistëve të institucioneve përgjegjëse në nivel lokal për problematikën e aftësisë së kufizuar. Gjithashtu në tetor të vitit 2008 u realizua debati televiziv me temë "Problematika e aftësisë së kufizuar në rajonin e Shkodrës" me aktorë të ndryshëm nga pushteti lokal, OJF - të dhe Zyra Rajonale e Punësimit. Debati u zhvillua pranë Tv Rozafa dhe pati një impakt mjaft pozitiv në opinionin publik të rajonit të Shkodrës.

Programi ligjor në kuadër të programeve të financuar nga Sëedish Helsinki Committee (SHC) gjatë vitit 2008 ndërmori inicjativën për realizimin e një studimi mbi kuadrin ligjor që vlerëson aftësinë e kufizuar në Shqipëri. Nevoja për të nxjerr në pah problematikën që paraqet kjo formë vlerësimi është bërë prezente për vite me rradhë jo vetëm nga specialistët të kësaj fushe, nga personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre por në mënyrë të veçantë edhe nga dokumentat politike si "Strategjia kombëtare e personave me aftësi të kufizuar" dhe "Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale".

Hartimi i këtij materiali u bazua në të dhëna sasiore dhe cilësore, të mbledhura nga pyetësorë dhe intervista me persona me aftësi të

Studimi i kuadrit ligjor mbi vlerësimin e aftësisë të kufizuar në Shqipëri

kufizuar dhe anëtarë të Komisionit Mjeksor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCA) në 6 qytete të Shqipërisë (Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Shkodër dhe Korçë) si dhe në bazë të analizimit të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë çështjet e aftësisë të kufizuar.

Materiali i përgatitur u prezantua në formën e një draft-studimi duke nxjerr në plan të parë nevojën për reformim të të gjithë sistemit të

vlerësimit të aftësisë të kufizuar në Shqipëri. Nevoja për reformim kërkon largimin nga modeli tërësisht mjeksor që bazohet aktualisht sistemi i vlerësimit për të shkuar drejt modeleve sociale dhe bio-fiziko-sociale që referon ICF- Klasifikimi ndërkombëtar i aftësisë të kufizuar (sistem vlerësimi që bazohet në vendet europaine). Draft-studimi u prezantua në një tryezë të rumbullakët me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, dhe e la të hapur debatin për reformimin e këtij sistemi me qëllim përfshirjen e komenteve dhe sygjerime të mëtejshme në përmirësim të këtij procesi.



Revistë e Financuar nga: Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

ÇFARE ESHTË FSHDPAK

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me aftësi të kufizuara, FSHDPAK është organizatë jofitimprurëse që prej vitit 1994, fillimisht si program i Oxfam-it për aftësinë e kufizuar në Shqipëri, dhe regjistruar prej vitit 1996 si një OJF e pavarur. Filozofia e FSHDPAK mbështetet në modelin social të aftësisë së kufizuar.

Misioni i FSHDPAK është promovim i shanseve të barabarta dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, me fokus të drejtat e personave me aftësi të kufizuar duke synuar përmirësimin e cilësisë së jetës për ta dhe familjet e tyre.

STRATEGJIA

Për realizimin e misionit të tij FSHDPAK punon ngushtësisht me individë me aftësi të kufizuar dhe shoqata të tyre, shoqata që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut dhe aktore të tjerë të shoqërisë civile, të institucioneve shtetërore e private, përmes zgjerimit e fuqizimit të partneriteteve, duke synuar në zhvillimin e fuqizimit të procesit të avokatisë e vet-avokatisë nëpërmjet informacionit, trajnimeve, ekspertizës ligjore e teknike dhe shërbimeve të tjera.

Programet e FSHDPAK ofrojnë

- Informacion në fushën e aftësisë së kufizuar
- Trajnim, Konsulencë dhe Ekspertize teknike
- Avokati dhe lobim me synim përmirësimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e aftësisë së kufizuar
- Asistencë ligjore dhe avokat falas për personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre
- Prodhim dhe shpërndarje të karrigeve me rrota(e vetmja e këtij lloji në Shqipëri
- Kampe të Rehabilitimit Aktiv për përdoruesit e karrigeve me rrota
- Punësim për njerëzit me aftësi të kufizuar
- Realizim i fushatave ndergjegjesuese përmes medias.

SFIDA 28

BASHKËPUNËTORË

Blerta Çani
Bardhylka Kospiri
Narbis Ballhysa
Florida Kalemi
Entila Zyba
Fatmira Çaçi

DESIGN AND LAYOUT

Orest Muça

ADRESA

Rruga "Bogdani" (ish-A.Z.Çajupi) nr. 15,
kat i 3, Tiranë Shqipëri.

Tel: ++355 4 269426

E-mail: adrf@albmail.com

www.adrf.org.al